



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2023

VENDIM

Nr. 470, datë 26.07.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 466,
DATË 25.07.2023**

Mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 97, pika 1, shkronja b) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 466 datë 25.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke caktuar veç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, edhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, si gjykata që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magjistratë, profili gjyqtar, gjatë vitit akademik 2023-2024.
2. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466 datë 25.07.2023, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke caktuar për kandidaten për magjistrate znj. {...}, si gjyqtar udhëheqës znj. {...} në sesionin e parë katër mujor korrik 2023 – tetor 2023 dhe znj. {...} në sesionin e dytë katër mujor nëntor 2023- shkurt 2024.
3. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, dhe gjyqtarëve udhëheqës të caktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR